VENDIM
Nr.1483, datë 12.11.2008

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.547, DATË 9.8.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR KRIJIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fund të pikës 3 të vendimit nr.547, datë 9.8.2006 të Këshillit të Ministrave, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

"Drejton dhe bashkërendon punën me strukturën e specializuar të Kombeve të Bashkuara, Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike (IAEA), si dhe ndërmjet strukturave shtetërore, institucioneve të specializuara, vendase dhe të huaja, universiteteve dhe qendrave kërkimore-shkencore, vendase dhe të huaja, sektorit privat, organizatave jofitimprurëse, grupeve të interesit etj., për të krijuar infrastrukturën kombëtare të nevojshme (përfshirë kuadrin e nevojshëm ligjor dhe rregullator, strukturat e specializuara të domosdoshme etj.), për vënien në jetë dhe në funksion të programit të energjisë bërthamore në Shqipëri.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha